

VENDIM
Nr. 152, datë 11.12.2015

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR
VENDOSJEN E GJOBAVE DHE KUSHTET E LEHTËSIMIT PREJ TYRE**

Në mbështetje të neneve 106/2 dhe 107, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe nenit 25 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.12.2015, pasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe relacionin përkatës,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për miratimin e draftrrregullores për vendosjen e gjobave dhe kushtet e lehtësimit prej tyre.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti